



Pranimja / Dorezimi / Received / Delivery	21. 04	2021	1	viti / god year
Organ / Njësia / Org / Unit	SKPM SHCK	1924 / 2021		
Nr Prot / Prot No				
Shtojca / Përfq / Appendix				
Sasia / Kolicina / Quantity				1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.192/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti -anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.192/2021 të datës 26.03.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi: Rruga “Nënë Terezë” numër 175, Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.192/2021 të datës 26.03.2021, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja sipas vendimit me numër: 01 Nr.112/02-19686 të datës 08.09.2021 të nënkryetarit të Komunës së Gjakovës është zgjedhur Drejtor në Institucionin Parashkollor “Ganimete Tërbeshi”, ndaj së cilës është shqiptuar masë disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës” nga Komisioni Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik me vendimin numër 01 Nr.116/01-1200 të datës 22.02.2021.

Ankuesja me datë 26.02.2021 ka parashtruar ankesë në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës. Komisioni për Ankesë për nëpunësit e Shërbimit Publikë i Komunës së Gjakovës ka nxjerr vendimin me numër Nr.01-070/01-4392 të datës 11.03.2021 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 26.02.2021 më këshillën juridike “se pala e pakënaqur në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë mund të inicioj kontest në gjykatën kompetente”

Ankuesja, në kundërshtim me këshillën e dhënë juridike, nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 26.03.2021 me numër protolli 1403/2021 e regjistruar me numër A.nr.192/2021, kundër vendimit me numër Nr.01-070/01-4392 të datës 11.03.2021, të Komisioni për Ankesë për Nëpunësit e Shërbimit Publikë të Komunës së Gjakovës



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.03.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Gjakovës. Ndërsa Këshilli me datë 16.04.2021 ka pranua nga Komuna e Gjakovës, përgjigjen në kërkesë me numër protokoll: 1832/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1403/2021 të datës 26.03.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; vendimin e Komisionit Disiplinor për Nëpunësit e Shërbimit Publik me vendimin numër 01 Nr.116/01-1200 të datës 22.02.2021; Ankesën e ankueses të datës 26.02.2021 parashtruar në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës; Vendimin e Komisionit për Ankesa për Nëpunësit e Shërbimit Publikë i Komunës së Gjakovës me numër Nr.01-070/01-4392 të datës 11.03.2021; Autorizimin e përfaqësuesit të ankueses i datës 23.03.2021; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Përgjigjen në kërkesë të datës 16.04.2021; Vendimin me numër: 01 Nr.112/02-19686 të datës 08.09.2021 të nënkryetarit të Komunës së Gjakovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.192/2021 të datës 26.03.2021, të parashtruar nga ankuesja **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave gjatë shqyrtimit të prova të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesja në bazë të vendimit numër: 01 Nr.112/02-19686 të nënkryetarit të Komunës së Gjakovës të datës 08.09.2021 është zgjedhur Drejtor në Institucionin Parashkollor “Ganimete Tërbeshi” në Komunën e Gjakovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave lidhur me kompetencën e shqyrtimit të lëndës, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 2 paragrafi 1 dhe 2 përcakton se: *“Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. Zyrtarë publikë janë: Nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); Nëpunësi i Shërbimit Publik; Nëpunësi i Kabinetit; dhe Nëpunësi administrativ dhe mbështetës”* përkatësisht neni 2 paragrafi 4 i të njëjtit ligj ka përcaktuar se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”,* po ashtu neni 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 dhe 1.32 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ka sqaruar shprehjet e përdorura në këtë ligj: *“Drejtor - drejtuesi më i lartë i një institucioni arsimor ose aftësues”* dhe *“institucioni arsimor apo aftësues i financuar me fonde publike - institucioni arsimor apo aftësues - financuar prej fondeve publike”* si dhe neni 20 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ka përcaktuar se: *“Drejtori dhe zëvendësdrejtori i institucionit arsimor dhe aftësues zgjidhen në bazë të Ligjit mbi arsimin në komunat e Republikës së Kosovës Nr 03/L-068, 21 Maj 2008, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MASHT me akt nënligjor, duke i shtuar edhe dy përfaqësues të Këshillit drejtues në cilësinë e vëzhguesve në komisionin e përbashkët të emërimit”* dhe *“Drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit”,* nga rrjedh se pozita e drejtorit të institucionit arsimor hynë në kategorinë e personelit drejtues të një institucioni që ofron shërbime publike në fushën e arsimit, andaj Kolegji konstaton se pozita e Drejtorit të Institucionin Parashkollor “Ganimete Tërbeshi” në Komunën e Gjakovës hynë në kategorinë e nëpunësit të Shërbimit Publik dhe se nuk është pjesë e Shërbimit Civil.

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e nenit 64 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas të cilave dispozita marrëdhënia e punës lidhur me nëpunësit e shërbimit publikë rregullohet me Ligj të Punës,



respektivisht kanë përcaktuar se: Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës. 2. Kjo pjesë e Ligjit përcakton rregullat për procedurën e konkurrimit, vlerësimin e punës, disiplinën e nëpunësit të Shërbimit Publik, si dhe procedurën e ndërprerjes të marrëdhënies së punës në rastet e vlerësimit "jo kënaqshëm" dhe shkeljeve disiplinore. 3. Një ligj i veçantë mund të parashikojë rregulla të ndryshme me këtë Ligj. Rregullimi me ligj të veçantë mund të bëhet vetëm në përputhje me parimet e përgjithshme të pranimit dhe menaxhimit të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji" si dhe nenin 24 paragrafi 4 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente".

Bazuar nenin 6 paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat për nëpunësit e Shërbimit Civil dhe kandidatëve që konkurrojnë për pranim në Shërbimin Civil, të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Andaj, pas konstatimit se pozita e Drejtorit të Institucionin Parashkollor nuk hynë në kategorinë e nëpunësit të Shërbimit Civil, Këshilli konstaton se nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.192/2021

Flakron Gashi


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

